

TEUTA KAMBERI-LIALIA

# ANTOLOGJI E POEZISË ARVANITASE



Teuta Kamberi-Llalla ka lindur në janar të vitit 1977 në qytetin e Tetovës.

Pas mbarimit të gjimnazit vazhdoi studimet në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filologjik dega gjuh-letërsi shqipe. Ka botuar disa studime për vjetërsinë e gjuhës shqipe në gazetatat dhe revistat shqiptare. Që nga viti 2003 punon profesoreshë e gjuh-letërsisë shqipe në gjimnazin e Tetovës. Ky është libri i parë i saj.

Çmimi 180 den. / 3 €

TEUTA KAMBERI-LIALIA

ANTOLOGJI E POEZISË ARVANITASE

Biblioteka: Poetika

Titulli: ANTOLOGJI E POEZISË ARVANITASE

Autori: Teuta Kamberi-Llalla, email: teutallalla@gmail.com

Redaktor: Ahmet Mehmeti

Lektor: Antigona Spahiu

Traskriptimin e teksteve: Arben Llalla

Radhitja kompjuterike: Suad Imeri

Botues: JETA-AIR

Copyright © Autori

Tirazhi: 1000 copë

Falenderojmë ndërmarrjet që ndihmuan në të holla botimin pjesërisht të këtij libri: (Farma VEZË SHARRI, Lecker, Trebosh), (minimarket VOKA, Tetovë), (Benzinata HIT-OIL, Tetovë), (Industria e mishit UKA, Saraj), (Industria e mishit VE-FA, Poroj).

## SHPIRTI ARVANITAS NË ANTOLOGJINË E TEUTA KAMBERI-LIALLËS

Në epokën e re ku ka hyrë kultura dhe letërsia shqiptare një dukuri e spikatur është dalja në dritë e një sërë antologjive tërësore e tematike etj. Një e tillë shumë interesante dhe me rëndësi të veçantë është edhe “Antologji e Poezisë Arvanitase” e autores së re Teuta Kamberi-Llalla. Kjo Antologji për herë të parë në historinë e letërsisë shqipe na sjellë një buqetë poezish nga arvanitasit më e afërt por, që rrethanat absurde të marrëdhënieve me Greqinë për lexuesin shqiptar ka qenë shumë e largët.

Për më tepër letërsisë në gjuhën shqipe në Greqi i është dashur të kalojë vështirësi të jashtëzakonshme, pengesa të paimagjinueshme që sistematikisht e mizorisht kanë ushtruar presione që ajo të mos dilte në dritë as në gazeta e buletine e jo më në libra të veçantë.

Dihet tashmë fati tragjik i minoriteteve etnike e kulturore në shtetin grek i cili, që nga krijimi i tij ka mohuar egërsisht zhvillimin e kultivimin e tyre.

Veçanërisht shqiptarët kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm në pavarësinë e Greqisë dhe me ndihmesën e tyre i kanë bërë nder edhe kulturës, letërsisë e artit grek. Dhe krahas këtyre kontributeve të njohura ndërkombëtarisht arvanitasit kanë krijuar një letërsi të vetën në gjuhën amtare ku kanë shprehur shpirtin e pamposhtur për liri duke evokuar e

himnizuar aktet heroike të figurave madhore si: Marko Boçari, Miauli, Bubulina e pafund heronj të tjerë.

Në këtë përmbledhje autorja Teuta Kamberi-Llalla është kujdesur të përzgjedhë poezi që i këndojnë bukurisë së atdheut, Moresë-Arbëri. Vazhdimësisë së trojeve shqiptare të lara me gjak në shekuj. Në një nga poezitë më të bukura si: “Oj e bukura More” shkruar nga një poet anonim i shek. XIV

Amanetin e të parëve për ruajtjen e identitetit kombëtar poeti Kristo Papadhopulli do ta shprehe me vargjet **Gluha jon**:

Kaq vitra shkuan  
prindët se haruan  
gluh e Besën na lan  
“të mos i haroni than”

Motivi i dashurisë gërshetohet me punën. Por dashuria është po aq motiv qendror:

Shume lule hapi vera  
Po si ti s’jan te tjera  
Shume lule hapi maj  
Po ne ti me ra sevdai

Ndihet fuqishëm motive social në poezinë e ndjeshme  
**Një konakjë:**

O, re djelma, kam merakj  
sej sa doja një konak  
Shum u lodhsh e re djalë  
tër ndë shpella e ndë male  
Nje kasholl të kesh i ziu  
mos me haj bora edhe shiu

Një vend të veçantë në vëllim zë poezia satirike si shprehëse e hollë e gjendjes shoqërore dhe qëndrimit të

autoreve qeveritare në mënyre kritike ndaj saj te **Ministrat Arvanitas**:

Kemi gjasht Ipurgo  
nuk vëlenjën një lepto.  
Kemi sum vulefti  
nuk vëlenjën po një-di.

Në poezinë arvanitase si në gjithë poezinë shqipe ideali paqësor është sundues. Kjo gjen shprehjen më të bukur në krijimtarinë e poetit dhe shkrimtarit të njohur Anastas Kulluriotit te poema **Të gjithë bashkepunonjë.**

Se këto ndë ki dunja,  
të gjitha janë të mbrazëta  
shpatatë thikat' le ti bëjmë,  
plorë, çapa edhe drëpënjë!  
njëri njatrënë mos vrasme,  
me dorë a armë, mos ngasmë

Arvanitasit jo vetëm që shprehën ndjenjat e tyre me poezi, por arritën të shkruajnë në shqip te poema **Per te paren princeshen tone Leksandra** ku vërehet një art poetik shumë i stërholluar për kohën (26 mars 1889).

Bie në sy përdorimi i figurave artistike si metafora e krahasime shumë të goditura:

e të vunë gaz ndë buzë,  
për të flasësh si thulluzë,

Në strofën që pason poeti arvanitas me inicialet Dh.Th. na shfaqet si mjeshtër i përsosur i portretizimit artistik:

Ti je mjallcëza e Privit,  
çë ndë lule bërdha rron,  
ti je mjalltëtë e kshivit,  
kur na flet e na shjon.

Në këtë përzgjedhje shumë të çmuar Teuta Kamberi-Llalla na sjell jetën komplekse arvanitase me heroizmat dhe privimet, me punën e dashurinë, me shpirtin e madh e të pamposhtur të tyre. Një pasuri më vete është pajisja me burimet ku janë vjelë e përzgjedhur këto perla të poezisë shqipe si dhe faksimilet në fund të librit.

Ahmet MEHMETI

## PARATHËNIE

Të hartosh një Antologji të poezisë arvanitase, është një punë e vështirë, duke ditur që arvanitasit e Greqisë, gjithmonë kanë qenë nën tryshninë e racizmit shtetëror grek. Në një presion të tillë, ata me shumë sakrificë ruajtën gjuhën, kulturën e tyre shqiptare, si dhe në fillim të viteve 1980 themeluan Lidhjen e Arvanitasve të Greqisë. Kjo shoqatë filloi të botonte revistën BESA dhe Kalendarin Vjetor, në faqet e të cilave pasqyroheshin pjesë nga jeta arvanitasve. Për këtë Antologji, ne shfrytëzuam pikërisht arshivën e Lidhjes së Arvanitasve të Greqisë, duke bërë një përzgjedhje të kujdesshme të poezisë arvanitase gojore dhe asaj të shkruar.

Si kriter kryesor vendosëm që çdo poezi të ishte shkruar në gjuhën shqipe me shkronja latine ose greke. Vendosëm kushtin që të ishte shkruar në gjuhën shqipe, sepse ka shumë arvanitas që poezitë e tyre i kanë botuar vetëm në gjuhën greke. Një ndër poetët arvanitas që poezitë e tij i shkruajti në gjuhën greke është Niko Egonopulos (1907-1985) i cili në vitin 1958, u nderuar me çmimin e parë për poezinë më të mirë nga Ministria Kombëtare e Edukimit të Greqisë. Dhe në vitin 1979, do të fitonte çmimin e dytë shtetëror për poezi<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Arben Llalla, "Gazeta shqiptare", Tiranë, 22 qershor 2008.

Në shumicën e rasteve poezitë na janë sjellë të shkruar në gjuhën shqipe jo nga autorët e tyre por nga mbledhësit. Një problem i poezisë arvanitase është se shpeshherë autorët nuk kanë vënë emrat e tyre, por i kanë botuar pa emra ose thjesht me emrin *një arvanitas i Greqisë*.

Një pjesë e mirë e krijimeve poetike arvanitase janë pa titull dhe neve na u duk më e arsyeshme që ti sillnim ashtu siç i kemi gjetur. Gjithashtu zgjodhëm ato krijime të cilat kanë vlera të larta artistike dhe nxjerrin në pah karakterin e vërtet të arvanitasve. Në të shumtën e rasteve poeti arvanitas, përmes vargjeve ka shprehur gjithçka rreth ndodhive të jetës së tij.

Në këtë Antologji janë përfshirë poezi gojore të cilat më vonë janë botuar në gjuhën shqipe nga vetë arvanitasit e Greqisë. Pra është një libër i poezisë arvanitase i seleksionuar nga krijimet gojore në të shkruar. Tekstet e poezive i kemi sjellë ashtu siç i kemi gjetur të botuara në gjuhën shqipe dhe për të qenë më realist po botojmë edhe disa faksimile nga janë marrë materialet e kësaj Antologjie.

Kërkimi për të gjetur poezinë arvanitase të shkruar është çështje tepër e vështirë, por ia vlen mundimi të merret njeriu me to, për pasurimin e mëtejshëm të kulturës sonë kombëtare.

Si përfundim dua të shtoj se ky libër është i pari i këtij lloji dhe shpresojmë që mos të mbetet i vetëm, por le të jetë një shkëndijë dhe nxitje e mëtutjeshme për punën e studiuesve që merren me çështjen e arvanitasve.

## FILIIMET E POEZISË ARVANITASE

Poezia gojore arvanitase ka luajtur një rol të rëndësishëm në paraqitjen e realitetit duke na bërë të njohur ngjarjet nga jeta e përditshme dhe problemet shoqërore. Vjershat me motive të ndryshme si nga ai familjar, bujqësor, kulturor, ekonomik dhe satirik kanë ndikuar në rritjen e vetëdijes dhe zhvillimin e tyre.

Më së shumti arvanitasit i thurën vargje ngjarjeve që lidheshin me luftën për liri nga pushtuesit e ndryshëm. Arvanitasit ishin një popull luftarak, krenaria e të cilit nuk mund të toleronte poshtërimet e skllavërisë dhe ishte e natyrshme që trimëria e treguar në luftërat për liri të shprehej dhe në vargjet poetike letrare. Por arvanitasit shprehën edhe shqetësimin për fatin e keq që po pësonte gjuha e arbërit. Në vargjet për gjuhën ata tregojnë dhimbjen kolektive shpirtërore për pa mundësinë e shkrimit të gjuhës së tyre. Dhe për ruajtjen e saj ata zgjodhën rrugën e të kënduarit.

Arvanitasit i kushtuan poezi edhe punës së përditshme që ata bënin. Poezi të shumta i kushtuan bujqësisë, blegtorisë, pra puna që ata bënin u bë frymëzim i krijimeve të vjershave duke shprehur botëkuptimin e arvanitasve për punën.

Në vargje satirike arvanitasit kanë vënë në lojë pushtetin në Greqi. Ata talleshin me punët e dobëta të ministrave, deputetëve, gjykatësve, priftërinjve etj. Satira arvanitasve ka pasur fat të mirë, ajo shumë shpejt arriti të botohej në gjuhën shqipe edhe në shtypin grek nga fillimi i shek. XIX.

Dashuria midis djalit dhe vajzës shpeshherë shprehej në vargje poetike që ngjallnin emocione për afrimin midis dy të rinjve. Në këto poezi vërehet besnikëria dhe ndjeshmëria e përrjetshme që shprehin të rinjtë për njeri-tjetrin.

Për herë të parë fillimet e poezisë arvanitase i ndeshim diku nga shek. XIII. Sipas studiuesit Aristidh Kola balada me titullin “Vdekja e Luftëtarit” mendohet të jetë shkruar në fillimet e viteve 1400<sup>2</sup>, kur turqit kanë hyrë në More (Peloponezin e sotëm) dhe arvanitasit luftojnë për t’i dëbuar ata. Balada “Vdekja e Luftëtarit” është ribotuar në vitin 1986 nga Giuseppe Schiro në Napoli, MCMXXIII, në festivalin “Këngë Tradicionale” që u zhvillua në Piana Albanezi pa titull. Por kur u ribotua nga shoqata “Lidhja e Arvanitasve të Greqisë” në kalendarin e vitit 2003, autorët i vendosën titullin që ka sot. Një dallim tjetër për këtë baladë nga regjistrimi i Giuseppe Skiroit është shkronja *ë* e alfabetit të gjuhës shqipe. Giuseppe Skiroi shkronjën *ë* e ka *ae*. Kurse arvanitasit shkronjën *ë* e kanë *e*, dhe shkronjën *e* e emërojnë *ε*.

Në vitin 1534 rreth 20.000 mijë arvanitas me në krye kapitenin Andrea Doria largohen nga Korona e Moresë në drejtim të Italisë së Jugut. Largimit të kësaj mase të madhe të popullsisë arvanitase nga trojet dhe shtëpitë e tyre u kushtohet poema “O e bukura More”. Për fat të keq ende nuk dihet autori që e krijoi këtë poemë e cila u kthye në himn për të gjithë popullin arbër. Por, për herë të parë poema “O e bukura More” u gjet e shkruar në vitin 1708, në dorëshkrimet e Kieutit. Filologu arbëresh Dhimitër Camarda (1821-1882), do ta ribotonte në vitin 1866 këtë vjershë në gjuhën shqipe por me shkronja greke në librin “Appendice al Saggio di Grammatologia Comprata Sulla Lingua Albanese”<sup>3</sup>.

<sup>2</sup> Lidhja e Arvanitasve të Greqisë, “ΜΠΕΣΑ”, Athinë, gusht 1992, fq. 108.

<sup>3</sup> www.lirionushi.com

Vite më vonë poemës “O e bukura More” do t’i shtohen edhe disa reshta të tjera nga Arqimadriti Pietro Camodeca. Kjo këngë-vaje që i kushtohet dhimbjes shpirtërore për braktisjen e pasurive të tyre u këndua për herë të parë në fshatin arbëresh Shën Dhimitri Korone në Itali. Pra, kjo poemë e kthyer në këngë nuk i përket krijimeve të poezisë gojore të arbëreshëve por, të arvanitasve. Dallimi midis arbëreshëve dhe arvanitasve është sepse arbëreshët emigruan në Itali nga Arbëria (Shqipëria), ndërsa arvanitasit shkuan në Itali nga Greqia.

Një tjetër krijimtari letrare e arvanitasve që u përket fillimeve të letërsisë së tyre është shkruar në vitin 1571, nga poeti luftëtar, Manoli Blesi në gjuhën italiane, por me shumë greqizma<sup>4</sup>. Manoli Blesi ishte një arvanitas i cili luftoi dhe përjetoi pushtimin e Qipros nga turqit. Pikërisht kësaj beteje ai i kushton poemën në vitin 1571, duke përmendur të gjithë arvanitasit që morën pjesë në këtë luftë.

Disa strofa të poemës, për herë të parë i gjejmë në librin e Mihail G. Llambrinidhu me titull “Οι Αλβανοί κατά την κυρίως Ελλάδα και την Πελοπόννησον”(Shqiptarët në Greqinë qendrore dhe në Peloponez), botuar në vitin 1907, Athinë. Vite më vonë për këtë poemë shkruan edhe Kostandinos Biris në librin e tij “Arvanitasit Dorjenët dhe Grekët e rinj”, po ashtu e përmend në librin “Arvanitët dhe prejardhja e grekëve” edhe studiuesi arvanitas Aristidh Kola.

Tek kjo poemë vërehet mungesa e gjendjes emocionale dhe mallin e poetit luftëtar. Mendoj se kjo ka të bëjë me çdo përkthim vargjesh të rregullt me rimë e metër. E cila përbën një problem serioz sepse është vërtetuar që përkthimi fjalë për fjalë dhe varg për varg humb pjesën më të madhe të shprehjeve shpirtërore origjinale të vlerës dhe bukurisë.

<sup>4</sup> Arben P. Llalla, “Gjurmë të letërsisë së vjetër të shqiptarëve të Greqisë 1860-1889”, Tetovë, 2006, fq. 22.

Në vitet 1860-1861 qarkullonte në Greqi një gazetë me emrin “Φος” (Drita). Në këtë gazetë botoheshin edhe poezi në gjuhën shqipe, njëra nga këto poezi-satirike është “Ministrat Arvanitas” e cila u ribotua në Itali nga arbëreshi Dhimitër Camarda në librin “Gramatologjia Komparata Sulla lingua albaneze per Demetrio Camadra”, botuar më 1866, fq. 86-88<sup>5</sup>.

Poema “Nde epara vasillopuva jone Leksandra” e botuar në revistën ΑΠΟΛΛΩΝ në vitin 1889<sup>6</sup>, mbetet krijimi më i madh vjershëror që për autor ka një arvanitas të Greqisë i cili ka shkruar në gjuhën shqipe me alfabetin grek. Poema në fjalë ka rreth 430 rreshta dhe i kushtohet fejesës së princeshës Aleksandra të Greqisë me dukën e madh të Rusisë, Pavlo Aleksandroviç, djali i perandorit të Rusisë Aleksandrit të Dytë. Edhe pse autori mbetet enigmë deri më sot kjo poemë ka një rëndësi të madhe për faktin se në fund të shek. XIX studimet albanologjike në Greqi ishin në fazën e lulëzimit.

Nga shek.XX poezia arvanitase filloj të shkruhej në masë më të gjerë në gjuhën shqipe se në shekujt e mëparshëm. Kjo fal punës së madhe që bënë intelektualët arvanitas si Jorgo Maruga, Aristidh Kola, Jorgo Miha, Jorgo Jeru, Vangjeli Lapi, Tasu Arvaniti, Alqi Gjika etj., arvanitas të cilët ishin grupuar në Lidhjen e Arvanitasve të Greqisë. Kjo shoqatë botonte revistën BESA dhe kalendarin e përvitshëm ku botoheshin dhe botohen ende sot e kësaj dite poezi, përralla, fjalë të urta, tregime, në gjuhën e tyre amtare shqipe

Pra, sot poezia arvanitasve shkruhet jo vetëm në gjuhën greke, por edhe në gjuhën e arbërit. Dhe kjo falë guximit dhe punës së madhe të vetë arvanitasve të cilët edhe pse në një trysni të shtypjes nga strukturat shtetërore greke ata kanë arritur të mbledhin dhe arkivojnë kulturën e tyre të lashtë shqiptare.

<sup>5</sup> Po aty, fq. 70

<sup>6</sup> Po aty, fq. 37.

## 1

**O E BUKURA MORE**

Petkat e të mirat tona  
 Na i lam te Korona  
 Krishtin na kemi me ne  
 Oj e bukura More  
 Thell të plas, me lot ndër si  
 Na të lipisnjëm, Arbëri!

Petkat e të mirat tona  
 Na i lam te Korona  
 Shën Mërin kemi me ne  
 Oj e bukura More!  
 Thell të plas, me lot ndër si  
 Na të lipisnjëm, Arbëri!

Petkat e të mirat tona  
 Na i lam te Korona  
 Papën na kemi me ne  
 Oj e bukura More!  
 Thell të plast, me lot ndër si  
 Na të lipisnjëm, Arbëri!

Malet tan me lis e driza  
 Të bukur sheshe me muriza  
 Të bukur kroje, të bukur gropa  
 Të bukur gjerdhe me fallopa!  
 Jemi e vemi ndër Itali  
 E më s'ju shomi me këta si!

Dherat të huaj hare s'kan  
 Se s'mbllin printët tan  
 Prindë, luftuat me thik më dor  
 Ndërpër shi e ndërpër bor  
 Ni ju lëm pa një qiri  
 E pa një vajim. Oj Arbëri!

Luajtim valle nd'atë More  
 Shtum kangjele ndë ato hje  
 Klisht e tona të bukuruara  
 Shpizit tona të nderuara!  
 Ni vjen Turku, Turku i zi  
 E tërpron klishe e shpi

Qeti: Shihni jet e re,  
 Na tha Dorja, zoti Ndre,  
 Lipim qellnjëm ka do vemi  
 Se buartim mallin e s'e kemi  
 Me këtë zemër, me këta si  
 Klajëm keq këtë Arbëri!

Ndallandishe e ler e ler  
 Kur të vish ti njetër hjer  
 Vjen të vish ti te Korona  
 E s'gjën më shpit e tona!  
 Më së gjën trima hajdhjar  
 Po ngë një qen, që kloft i vrar!

Kur u nistin gjith anit  
 E dherat tan iktin ka sit  
 Burrat gjith me një vajtim  
 Thirrtin grat me një vajtim,  
 Dil e hana ti, Stihji!  
 Oj More! Oj Arbëri!



## 2

Kristo Papadhopulos

**GLUHA JON**

Kemi gluhën pa gram  
si na e than në mend e mbam.  
Gluha vetëm flitet  
edhe sa vete ritet

Ritet edhe shtonet  
nuku pakësonet  
shtonet edhe ritet  
edhe sa vete flitet

Gluha kuvendonet  
edhe sa vete shtonet  
Arvanite me kamar  
kudo ven jan të par

Kaq vitra shkuan  
prindët se haruan  
gluh e Besën na lan  
“të mos i haroni than”

## 3

**GLUHA**

Arvanitat këndonin  
gluhën mos e haronin  
Gjigjion si këndon ai plaku  
shihe si lëviz ai gjaku  
Goj m’ goj e mbahet jeta  
mbahet me këng t’ drejta  
Arvaniti s’ mund t’ shkruan  
me këndimin tër i ruan.

## 4

Vagjel P. Lapi

### NE ARVANITASIT

Gluha jona, vetëm thuhet,  
nuk' e llan për t shkruhet

Këng porsimet shtruora  
t mos ven haruora

Nga Sokrati e Perikliu  
xum si vete ndreqi niriu

E nga Aristidhi vet  
xum koma ç isht e drejt

Mendi Mistos, Ksenofon  
isht qesem e na mbëson

Ng'ata bura, sa ç shkuan  
mendi in ç than, e ruon

Ng' ato mende muorm frim,  
Sa na than, mir i dim

Na dhan krehe, hapët mend  
ng' ajo fort e mbam vent

Arvaniti, ku lluftoj  
nga tuti ipari shkoj

## 5

Mos rim si t' vdekur  
malet t' marëm tor  
t' vishemi nd' hekur  
t' marëm pall nd' dor  
Po ngrini kriet, zemëra pllort  
kulitoni prind tan  
pse at vend ç' rojm sot  
llëruor na e dhan  
Me frim lliris, me këto arm  
ti shtijm turqit nd' det  
vendin llëruor t' e bam  
ashtu t' e tshonin djelt

## 6

## MINISTRAT ARVANITAS

Kemi gjasht Ipurgo  
nuk vëlenjën një lepto.  
Kemi sum vulefti  
nuk vëlenjën po një-di.  
Kemi edhe një Muxuridh  
do na muxurisnj sit.  
Mir bën edhe Karidhi  
çë thëret vre Muxuridhi  
Edhe ipurgi bën mir  
t'ë dërgonj ndë Sirë  
të ikënj edhe nga këtu  
pse u tha, e u bën dru.  
Këto thom, edhe s'thom më  
pse ndë filaqi më vë.

## 7

## DASHURISË

Do pjenjë sajten  
si e shkon vajza ditën  
  
Vajza nat edit n' argali  
Djali nuk e sheh me si me si  
  
Jain vajza nat e dit  
për të drenjë sum prik  
  
Do bënem gjarpr me pika  
ti shkone vajz ne sajta  
  
Do bënem gjarpr i bardh  
ti shkoni vajz në mitar

## 8

## SATIRË

Ç e ve tragjashkën shtrëmbër  
Të më çëpos zëmrën;  
Tartëgji re bukuzi  
ç mëvjën tër një n'avlli  
si gjadhur ç do tagji

Tendra mua ish ni pram edhe liviz  
si një gjarp pa bisht  
hapa misofofin të zër  
shkau dhemoni e hiri ne vër

Moj Garefo zure u mblakse  
të shtrëmbër ç dje nuk lashe

Mëkat shumë Garafale  
pa bur je e vetm s'fle

Mikun ç nani çove  
s'të ka qe ç vjen pasoe

Folm Garefo si me flase  
mos ke turp ç më lashe

S'më do timos u s'të dua  
ç për tiedhe për mua

## 9

## PRIFTI I KATUNDIT

Do japim tuti nga ni pulli  
ti blem priftit ni ksull

Do japim tuti nga ni qengji  
ti blem priftit ni rryp

Do japim tuti nga ni vit  
Ti blem priftit këmish

Do japim tuti nga ni ber  
të blem për klisinë ksefter

Do japim tuti nga ca grurr  
ti blem priftit ni gjadhur

Do japim tuti nga ni ve  
ti blem edhe prëftresësh ni podhe

Do japim tuti nga niçik musht  
ti blem priftit këpuc

Do bëjm edhe ni kamin thingjill  
ti blem priftit petraqilli

## 10

## PËR DITËT E JAVËS

E Hënë  
 Dojë të lanjë të Hënëne  
 rashë e çajta këmbënë  
 E Martë  
 Dojë të lanjë të Martënë  
 mëma s'më mbaj djalënë  
 E Mërkurë  
 Dojë të lanjë të Mërkurë  
 dosa më hëngër sapunë  
 E Enjte  
 Dojë të lanjë të Enjtenë  
 kali buar shegljenë  
 E Premte  
 Dojë të lanjë të Premtenë  
 kush të mbaj të krëmtënë  
 E Shtunë  
 Dojë të lanjë të Shtunë  
 keshë njatrë punë  
 E Dielë  
 Të Dielë çë do Këngonjë  
 nxora gunënë e pleshtonjë.

## 11

-U jam nikoqir i ri  
 bleva një ghaidhur të zi.  
 U jam nikoqir i parë  
 bleva një ghaidhur të bardhë.  
 -Ç'ë ke tërë këtë kamar  
 kur ke ghaidhurë pa samar?  
 -Ea të na shosh mularë  
 ç'e kemi kurupit marrë.  
 -U a kam parë edhe mularë  
 tri këmbë dhe një të çarë.  
 The mu të i ngorth mular-i  
 t'i ullej djalit kamar-i.  
 -Ea të na shosh shtëpinë  
 sa e bukurë, çë rrimë.  
 -Dhe shtëpinë u a kam parë  
 ishtë etim për të rarë.  
 -Ea të na shosh ambarë  
 e kemi plot grurë të larë.  
 -U a kam parë dhe skatharë  
 malimënga dhe skatharë.  
 Vate djalë-i të kungon  
 shtiu kandilënë çë shkon.  
 Vate djalë-i t'anispas  
 kërismë shokëtë një gas.

## 12

Krinë dhe gharifalë  
pemë e bukur, që je  
për të ndijurë në hje.

Shumë lule hapi verë-a  
po si ti s'janë të tjera.  
Shumë lule hapi Maj  
po në ti më ra sevda-i.

Keni soj ka trandafile,  
jeni trima edhe kopile.  
Sojnë e keni ka pjeshkë  
jeni trima edhe të zeshkë.

-Thuaj më sa vëlezër ke  
t'i fiteps portokale.  
Thuaj më sa vëlezër jeni  
t'i qendis lule në podhe.  
Thuaj më sa vëlezër jeni  
T'u këndoj kudo të veni.  
-Vëlezër, motëra pesë-gjashtë  
si vasiliko-i në ghastrë.

## 13

## VAJTIMI I SHËN MËRIS

Ng' ande parr  
vin një andarr  
vin një grua  
tuke klar  
Vin një grua  
gjoketh plote  
tuke mbiturr në lote.  
Ng' ande par  
vin një andarr  
Shirmëria tuke klar.  
Tuke klarr duke thirr  
pse i vran monobirr.  
Tërë zjarm edhe shëm perr  
këmb duarrt të prërr.  
Pse epa shtatarosur  
nd një krig karfosur  
Kush të vrau meregjet  
ata qenët ata Ovret  
Djalithim nga thika shkove  
zembrën ma pïrvlove  
Sa e dhe drizat u thanë  
nga tromareza ç pane  
Mblidhi lule nga të kroi  
për ti vëm tor Krishtit  
Mblidhi lule ng të malit  
për ti vëm tor djalit  
Mëma nga djal ç të vajton  
Vet mua të kulltoni.

## 14

## Një KONAKJË

O, re djelma, kam merakj  
 sej sa doja një konak  
 Shum u lodhsh e re djalë  
 tër ndë shpella e ndë male  
 Nje kasholl të kesh i ziu  
 mos me haj bora edhe shiu

At katundin tat e kemi,  
 edh' atia djelt jemi.  
 Ngritim ledhe edhe strojera  
 e s'na ze shiu edh' era

Atje bëm edhe shtëpin  
 edhe njohem prokopin  
 Nde shtëpia u len djelt  
 Trandafile plot flet

Për at vendin, at katund  
 edhe at shpirtin jepe  
 pse katundi ter i mund  
 edhe ai te shtoj nga djepi.

## 15

## VDEKJA E LUFTËTARIT

Duall e bukura në derë  
 Me një shtamnezë me verë  
 e me qelqethin në dorë  
 jip të pijn të varfëret.  
 O ti mjer i varfërit  
 çz më vjen ng' amazeza  
 mos më pashe zotin t' im;  
 Pash shumë luftorez  
 zotin tëndë nuk e njoha.  
 Ish një trim i bukurith  
 mukur dhe i jelburith  
 me mustaqë të ngrehurith  
 me një kallë të brimurith  
 me një sellë mëndafshëtë  
 me një nigë të velushtë  
 me një frenthë krisonem  
 me një flamurë në dor.  
 U m' e pash, o zonjë kallthin  
 qei sellën nga barkut  
 e me flamur dzarë dzarë...  
 Arru kalli ndër të thënët  
 Se to i shkret e i halinosmë  
 ku m' a lashe zotin tëndë  
 zotin tënd e zotin t' im;  
 U gjith fushazit m' i rodha  
 gjithë pronjezit kërceva

e gjith malezit m' i jetsa.  
Pro në fushë të Anapulit  
ne një humbjez s' i arrëjta  
mbi një drasë të marmurtë  
m' i kumbisa këmbëzit,  
po më 'shkan të katrëzet.  
Qeni Turk më 'ra përsipër  
ë m' i qethi kriethit.

## 16

Mot e shum kazand i mir  
ç na ban zotë o, je mir;  
Mir jam si do zoti in  
Ia zot o, ia zoni  
Ia ashtu si vjen ai fili  
ashtu t t roni i biri  
edhe spitonikoqiri  
Me sakulen t krisat  
me gaitan t krisostaft  
Ni her nd mot nd mot  
t pagues rusoliot  
And t t z' r dora shum  
ni flori e ni dukat  
jepua trimave  
me urat, me urat



## 17

Mirë se na erdhi vit i riu  
 mirë se të na pëlqenj.  
 Si sot-Thojnë të vjetrëtë-  
 jia të Ser-Vasilitë,  
 njëri çjë vjen ga e mira,  
 çjë vjen ga kallomira.  
 Në derë t' avlloportësë  
 du zojqë çjë këndoinë  
 çjë kanë sitë ga dhiamante  
 edhe për Krishtin u ndisën  
 edhe për të kënduara  
 një Dukim e u jipin.  
 Gjigjuni vllazër, gjigjuni  
 gjigjuni edhe gjitone:  
 Mos ja ndonjë i varfërë  
 mos ja ndonjë i shkretë  
 mos ja ndonjë i shklepurë  
 çjë nuk mundon të vinjë;  
 Mos ja ndonjë çjë sgjigjetë  
 mos ja ndonjë sëmurmë  
 mos ja ndonjë i vërbuar  
 çjë nuk na sheh i ziu;  
 Trëgonj ndonjë pjatë fai  
 tregonj gjë të ëmbla  
 edhe Krishti do na vinj  
 bashkë me vitin e ri.  
 “Motë më shumë”

## 18

**DhERVENOXORITIKA KALANDA**

Mir se të vini viti iri  
 mir se mir se të na çoni  
 Zonja e shtëpis e zoti  
 ni mil vitra të na roni,  
 të ken tëmira, hare edhe gaze,  
 të mos ken seklet, kajmo edhe maraze.  
 Po jeni georgo ni mill shos të bëni,  
 të mblonet shtëpia të mbetet e nga llëmi.  
 Po jeni çopan me dhen, me dhi,  
 të shtonet kopet tri her  
 sa të shkoni viti iri  
 të mblonen malet edhe laka  
 tër lae edhe bardhaka.  
 Po bëni njaty pun,  
 dhiafori të jet llum.  
 Me zembr e me aspiert  
 U thomi mote shumë.

## 19

## MARK BOÇARIT

Bie bor e bie shi  
 u xi jeta, shum, u xi.  
 ngrin krie në Graiqi  
 zjarrë vun ne shum xhami.  
 Ferman në gjith Turqi...  
 Prite, prite, o Rumeli  
 nizamet lloj-lloj.  
 Pashai me Miriallan  
 në çader bërdha van.  
 ‘Inshallah’ të gjith than  
 për në Mesollogjill e kan.  
 ‘Fuora’, palla e jatagan,  
 të ndërojn sa jan  
 të luftoin me Rajan.  
 Mesollogji me ndigjon  
 vuri vajete e vajton  
 Duaj ndihm s’ çon,  
 Kapetanët kërkon  
 Zuri rënjën e rëkon  
 Shqipetarët vëzdon.  
 Ishin bërdha Shqipetar  
 shahina, trima pa an  
 nga Suli u ngren e van  
 me dufeqë e jatagan.  
 Ish një bur, trim, iri  
 i zeshk mustaqezi

po rij me mallengoni  
 mbaj dorën mbi harmbi  
 mbaj vesh e s’ flit njeri,  
 Marko Boçari ish ki.  
 Mbaj vesh edhe ndigjoj  
 psheretiu edhe rëkoj  
 nga trimat e tij vëzhdoj  
 rëmbeu karjofil e shkoj.  
 Tha: “Do vdes a do roj  
 këtë jet, s’ mund te shkoj  
 nat e dit, “oj” dhe “oj”!  
 Shoket tij nëmëroj  
 treqind vet plot i mblodhi.  
 U thot: “O shok, o asllan  
 Mos e gëzojm, dinjan  
 si Raja ne Turkollar!  
 Sonte do t’ u derdhim gjakun  
 t’ u ndrojm din e iman.  
 Sonde t’u biem pran  
 se kam “Tan a epitan”  
 të zë nga mjekrët Pashan  
 Katillar, e Agallar.  
 T’i pritni me jatagan  
 asnjë mos lëni të gjall.  
 të shkulet kjo farr  
 se na poq, ena vu zjarr  
 Muhameti me Kuran.  
 Folni Shqip me Shqiptar  
 “Bam” pos bëni as mb’ një an.  
 Gjasht-dhjet eni pran  
 sa të rëmbejm Pashan.  
 Ngadale, o kordhetar  
 vrsini karaull e par.

Vrisni një e vrisni dy,  
 vrisni sa shihni me si,  
 si kur ullqët në dhi.  
 Allah, Allah o Turqi,  
 at vat ç holqe ti,  
 at vat në erreshi,  
 shkrëtove kaqë ordhi.  
 O shokë “medet-medet,”  
 shkoi Markoa si Mbret!  
 Pashan kërkon e s’ flet,  
 në çader nuk e gjet.  
 Zu nga mjekrët një lanet,  
 turqe helqur thërret:  
 “Aman thua j m kush je;”  
 “U jam, derk nuk më njeh;”  
 ‘Aman more çili je ti;’  
 Dar i darit, nuk ë di;  
 Jam një kapedan i ri  
 thuhem Marko-Boçari,  
 erdha vetëm për ty!  
 Turk i dar e zuri dridhm  
 shokërit u vu një thirm:  
 “Turqë të mbesoni din  
 të më shpëtoni fat-zin,  
 Se Kaurët më bin!”  
 Dar i darit, nuk di;  
 Jam një kapedan i ri  
 thuhem Marko-Boçari,  
 erdha vetëm për ty!  
 Turk i dar e zuri dridhm  
 Shokërit u vu një thirm:  
 “Turqë të mbesoni din  
 të më shpëtoni fat-zin,

Se Kaurët më bin!”  
 Një Arrap me karabin  
 u ul e i shtroj syn,  
 koditi bajrakën e mir,  
 Marko Boçar in shahin!  
 E vrau!! “Shokë Shqipëtar  
 binu qent se më vran.  
 Më muar plumbi në ball,  
 mirmëni sa jam i gjall”.  
 U xi jeta, u bë mugjë  
 tërë trimat si u ngullën  
 e bën se duall ujë  
 djelët e Sulit me vull  
 Shahinat ne dor e muar  
 edhe ne Mesollogjë e pruar.  
 E pruar në Mesollog  
 te shpëtonin, po s’ shpëtoj.  
 Mesollogji u helmua,  
 derdhi lotet si kua.  
 Mesollogji, po t’a thon,  
 ku e ke Markon Sulion  
 Ku lufton si qej zakon  
 Tërër me jatagan në dor;

## 20

Anastas Kullurioti

## XINXARI

Pra sa të dua ti, nxinxar, o këngëtar!  
 nd' ajo degë, çs' je ngalkuar mbë të kotë  
 medrekj ishtë a mesditë, per ti ishtë bëhar  
 dh' as një para sjep ti për gjithë botë  
 Të ngrëna, e të pira s' ibën për këtu...  
 as mos' ngargomë bëne. / si tëi pëlqen  
 Ti dëgëza këjon; / vete e rri më më tëhu.  
 Ndë të ngjuajshin dh' andej; ti eshkjëlלקjen.  
 Të klajsh, a të rëkojsh kurrë s' eke ndër mend,  
 ndë mos të ndaftë njëra, ti çson njatrë,  
 dunjaj s' ubuar, dhe për ti ishtë tër një vend,  
 e le të thonë se je.  
 Vetëmë lerë je të këndojsht gjithë mot,  
 dhe këngatë nga jeta m' ike dzënë,  
 az me pahir kërkon të të japë inë Zot,  
 ati tshë sdesht me hir të të kish dhënë.  
 Thonë se dhe ipëderëz je, nxinxar ivarfër!  
 se u lutshe milingonës' një grusht grurë!  
 tërremëtort'! munjafiq jan ë si gjarpër,  
 se kur, izithi, ;sjlashe degen' e drurë!  
 S' ke fajth ti! se kur do dunjaj ashtu, isht'  
 ikejçq, mërçitën këmbëtori kalëtorin,  
 edh' as ipaturi atë çsë ska ehelq,  
 as nusen' plaka', as plaku dhjalëtorin.  
 Këndo pra mik, dunjanë kurrë mos e pjejt,

këndo ti kaqja bukuri të kota  
 e pra ndë vdirresh ti nga uja, mos të pret,  
 podë do mos vdirret' e gjithë bota;  
 Me mir' të ngorthsh nga uja, se ti hash ti sot,  
 atë çsë me punim mblodhe të tjerët,  
 e pra, nani ndë jesh ivarfër, ka inë Zot.  
 Do vinjë kohë, të pejrojsht, imjerë!...

## 21

Anastas Kullurioti

**TË GjITHA BASHKËPUNONJËNË**

Tërë punojmë ndë ki dhe  
 se ashtu ishtë çthë na ka hje  
 Ca me duar, ca me mendë,  
 ca me mendë, ca me parmendë  
 ti punon me plor me qe,  
 qëron arnë glëmkuqe  
 u punoj me gjidhë marrë  
 sipr mbë një kartë e bardhë.  
 Ti avllaqe bën të nglatë  
 u aradhazë ndë kartë.  
 Ti mbjell farënë mbë lashtë  
 e pret të bësh buk' e kashtë  
 u fjala shkuanj mbë kartë  
 Ti avllaqe bën të nglatë  
 u aradhazë ndë kartë  
 të prjer mendë të marrëtës'  
 Me ndjersë arënë ti e vadis,  
 me gjak pemën' ti eskalis.  
 ndë kart' u gjurmonj surtuqe  
 gjurma zeza, gjurma kuqe.  
 Tërë punojmë ndë ki dhe,  
 s' ashtu duhe të mere.  
 Nëkë shihni bletënë  
 si përpjekën vehtënë,  
 mbë gjithë lulezë po rri

e mbleth mjalt' edhe qeri.  
 Pra shihni edhe greth' ezi,  
 që ngjoheshtë me mërrzi.  
 Pse smbën punazë të drejta  
 po vjedh mjaltëtë nga bleta  
 edhe bleta eze dh' evret,  
 dhe kufarrth ja shtje ndë dhe.  
 -Pra, shihni edhe milingonën,  
 që andej këte na pret dhromnë,  
 pra mbleth koqe, pra mbleth drudhe,  
 pra mbleth drith edhe marulle.  
 Mbleth soron' e bën hazne  
 per dimër t' iqetë mere.  
 Pra shihni edhe fluturaqën',  
 që këcen-këcen pra bllakën',  
 fluturon lule mbë lule!  
 veshurë rroba të mëndafshita  
 shkëlqim-bukura përjashta,  
 t' idura me shum kollarë  
 verponjën' sitë, po t' ishohë.  
 Po shkon jetën', pa qëllim  
 e pra ngorth po lërë kuljtim.  
 'Ashtu jan', edhe ata trima  
 që punonjn' si ajo krimba!  
 Pse spunonjën' dhe para skanë  
 kur mblakenë që të hanë.  
 Gjegjuni trima të ngërdhimë,  
 le ti lëmë ato që dimë  
 Me pakjë pra le të rrojmë,  
 qet-qet, jetën' të shkojmë.  
 Se këto ndë ki dunja,  
 të gjitha janë të mbrazëta  
 shpatatë thikat' le ti bëjmë,

plorë, çapa edhe drëpënjë!  
 njëri njatrënë mos vrasmë,  
 me dorë a armë, mos ngasmë  
 Qe ti forrë;... ngrapu me dhenë!  
 -Se, sa epret aqjë të prekën.  
 Bota do përshurshurishur',  
 me pleh e me ujë vadisur'.  
 Me djersë tënë do potiset',  
 me shërbes ara stoliset.  
 Me punim bukën' të hamë  
 të lodhur ndë shtrat' t' emarmë.  
 Me paqitim, jetën' të shkojmë,  
 të keqjetë ti harojmë.  
 Me shëndet ti jemi sa rrojmë,  
 pa shërëtor të na shëronjë  
 Tërë punonjën' ndë ki dhe,  
 se ashtu ishtë çë u ka që  
 punon ara, deti,  
 punon dheu, punon qameti  
 punon qielli me illjt.  
 Punon Kora, punon Vjeshta  
 Vera, Dimëri edhe vreshta  
 linjtë e pematë pononjënë!...  
 veç tembelëtë rëkonjënë!,,,  
 Kush punon, ka dhe para,  
 ka gjitha të mirata  
 po, tembeli e pashërbjeri;...  
 ngorth nga ujlëza imjeri!...

## 22

Mitro Truqis

## LULESANA

Lulesana vej të kuar  
 ira drapëri e buar!  
 Mblidhuni argat te çojmë  
 pë' r mos barë argatikonë.  
 Van' e çuanë draperinë  
 ate dhë' mbë gjarpërinë!  
 Pa kur zu Lulsana e kuar,  
 të' rë argatia u buar.  
 Ndju se sa ebë 'n, rrimadhë...  
 di-tri limare nd' aradhë  
 Kur do lith, nje tromarjare...  
 dhëmë sifturisë fare  
 kur do ilith; kur do ishtrëngon...  
 çë' do fare, çë' kërkon...  
 gju vij ngljun' i zgjas ndë mes,  
 dhëmët' i këpun si preshe.  
 Kur këputi njatrë, ksana,  
 fundit prapëtë, Lulesana.  
 Poqi krietë do pllakë.  
 ..... tërë ndë llakë.  
 Nde kaj zjarm, nde kaj kaimo...  
 na, edhe plaku Kollovo!  
 "Plasi dheu nga posht' e vuall;..."  
 Nga katadhiavolu duall;  
 U qas e itha ndë vesh,

moj rri... kali psiqi, të' qesh.  
 Podë jemi, gjë' të' huaj;  
 Nga një soj-nga soj juaj.  
 Tata im, ish nga Koleshtë,  
 Nde një thes, e ve' rëm leshtë...  
 Tata im, edhe jot' ëmë...  
 Prire kashtënë ndë' lëmë  
 Qafrë atjë nga mesimeri  
 thuaj se e katiferi.

## 23

Dh.Th

**NDE EPARA VASILIOPUVA JONE LEKSANDRA**

**Të këndonnë ndë arbërishte,**  
**Ç' ishtë gluhë trimmërishte,**  
**Ç' eflit nafarhu Miauli,**  
